



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Tel: 038/200 438 14

DRAFT-RREGULLORE PËR SUBVENCIONE NË KOMUNËN E ISTOGUT

P R O C E S V E R B A L

Nga dëgjimi publik për Draft-Rregulloren për Subvencione në Komunën e Istogut mbajtur më: 22.05.2025, në Sallën e Kuvendit Komunal, filluar me punë në ora 10:00.

Në Dëgjim ishin të pranishëm:

1. Ilir Ferati, Kryetar;
2. Drejtor të drejtorive Komunale;
3. Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit
4. Liliana Frrokaj, Zyra e Kryetarit;
5. Alketa Bujupaj, Zyra e Kryetarit

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati dhe Drejtoret e Drejtorive

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim, Genc Ademaj **Drejtori, z. Genc Ademaj** – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje dhe hapi dëgjimin publik për Draft-Rregulloren për Subvencione në Komunën e Istogut dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Njoftimi për Draft-Rregulloren për Subvencione në Komunën e Istogut,
2. Pyetje dhe Përgjigje

Konsultimi publik u mbajt me qëllim të prezantimit dhe diskutimit të Draft-Rregullores për Subvencione, e cila ka për synim rregullimin e procedurave dhe kritereve për ndarjen e subvencioneve komunale për kategori të ndryshme përfituese.

Takimi u hap nga drejtori i drejtorisë përkatëse, i cili sqaroi arsyen e hartimit të kësaj rregulloreje dhe nevojën për një qasje më të qartë, të drejtë dhe transparente në shpërndarjen e mjeteve financiare komunale. U theksua se rregullorja synon të shmangë paqartësitë dhe keqkuptimet e deritanishme.

Gjatë prezantimit u shpjeguan kriteret për përfitim, procedurat e aplikimit, dokumentacioni i nevojshëm dhe mekanizmat e monitorimit. U theksua rëndësia e trajtimit të barabartë të të gjithë aplikuesve dhe vlerësimi objektiv i projekteve të paraqitura.

Pjesëmarrësit shprehën mendime dhe sugjerime lidhur me thjeshtësimin e procedurave të aplikimit, rritjen e transparencës në fazën e vlerësimit dhe nevojën për njoftim më të qartë të përfituesve dhe jo-përfituesve. U diskutua gjithashtu rëndësia e subvencioneve për zhvillimin e iniciativave lokale dhe përkrahjen e bizneseve të vogla.

Në përfundim, u theksua se komentet e dhëna do të merren parasysh gjatë finalizimit të rregullores dhe se komuna do të vazhdojë të promovojë politika mbështetëse për zhvillimin ekonomik lokal.

Procesmbajtës:
Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave

